



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-138

Prishtinë, më 16 dhjetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 DHJETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë:

- 1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe*
- 2. Propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave për kryetarin dhe për anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor.*

Nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, u deklarua kundër propozimit që në rend dite të mbledhjes së Kryesisë të shtohet edhe propozimi i Komisionit për buxhetin e vendit për vitin 2014.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 dhjetor 2013,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 dhjetor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 dhjetor 2013.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 19 dhjetor 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Planit të Veprimit për vitin 2013-2017,
5. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012,
7. Debat parlamentar lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013,
8. Debat parlamentar lidhur me ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,

9. Formimi i Komisionit ah hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,

10. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

* * *

Visar Ymeri i propozoi Kryesisë që debatin parlamentar për procesin e privatizimit të Fabrikës së amortizatorëve të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Kryesia miratoi propozimin e lartpërmendur dhe vendosi, që ky debat të radhitet në rend të ditës, në njërën nga mbledhjet plenare të radhës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Informata e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me inputet për raportin e progresit për Kosovën për vitin 2013, si dhe Raportin për ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Për pikën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit; Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së; dhe Visar Ymeri, kryetar i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, i radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, veç e veç, kërkesën e ministres së Integriteteve Evropiane dhe kërkesën e GP të AAK-së për debat parlamentar.

2. Kërkesa e deputetit Elmi Reçica, mbështetur edhe nga tetë (8) deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me privatizimin e Fabrikës për Prodhimin e Gypave në Ferizaj

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartcekur, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga propozuesi i mocionit për debat parlamentar, deputeti Elmi Reçica, që mocionin ta plotësojë me tekstin e rekomandimeve dhe arsyetimin e tyre, para se i njëjti të procedohet në seancë plenare.

3. Procedimi i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik

Kryesia, pasi diskutoi për procedimin e projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- Projektligji për shërbimin gjeologjik, i hartuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funkcional, që ta përgatisë raportin preliminar për shqyrtimin e parë të Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

4. Kërkesa për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- Kërkohet nga grupet parlamentare që deri në seancën e radhës, më 19 dhjetor 2013, t'i propozojnë deputetët për formimin e Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.
- Përbërja e Komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i KKR-së, 1 anëtar; GP SLS/GP ZB-së, 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

5. Rekomandimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për shkarkimin e 3 (tre) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Për rekomandimin e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit; Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së; Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së; dhe Adem Grabovci, kryetar i GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia e radhiti shqyrtimin e këtij rekomandimi për mbledhjen plenare të radhës, me emërtimin: Rekomandimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për shkarkimin e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, pasi njëri anëtar i këtij komisioni në ndërkohë ka ndërruar jetë.

6. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për realizimin e vizitës zyrtare në Parlamentin Evropian, prej 25-26 nëntor 2013

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për realizimin e vizitës zyrtare në Parlamentin Evropian, prej 25-26 nëntor 2013.

7. Njoftim me shkresën e ish-anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të këtij këshilli nga Komisioni ad hoc

Kryesia u njoftua me shkresën e ish-anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, të cilët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të këtij këshilli nga Komisioni ad hoc.

Pikat shtesë:

1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014

Për rekomandimin e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, nënkryetar; Adem Grabovci, kryetar i GP të PDK-së; Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së; Visar Ymeri, kryetar i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”; dhe Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që pasi të dërgohen raportet nga komisionet e përhershme lidhur me këtë çështje, në mbledhjen e radhës së Kryesisë të procedohet Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 për seancën plenare të radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale